



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 48 dt. 22.08.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 22.08.2014, pasi shqyrtoi çështjet e diskutuara më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, lidhur me:

1. Kërkesën e Autoritetit Rrugor Shqiptar “Mbi konfirmimin e zonave të shërbimit në funksion të Parkut Arkeologjik të Apollonisë” me sipërfaqe nga 25.000 m2 secila, të parashikuara buzë autostradës së “By Pass i Fierit” Korridor Veri-Jug,” **vendosi se:**

“Nuk janë të nevojshme këto dy zona shërbimi, pasi nevojat lidhur me hapësirat e kërkuara janë plotësuar në Masterplanin e miratuar të Parkut Arkeologjik të Apollonisë”

2. Shqetësimin e ngritur nga Drejtori i Parkut Arkeologjik të Apollonisë, për disa përpjekje të mbetura në tentativë për marrjen e materialeve inerte brenda zonës së mbrojtur të Parkut **vendosi se:**

“ ZAPKA e Apollonisë të ndjekë problematikën e mësipërme duke ju drejtuar zyrtarisht të gjitha instancave përgjegjëse, për të shmangur cënimin në të gjithë zonën e mbrojtur të Parkut Arkeologjik të Apollonisë dhe të sigurojnë ruajtjen të paprekur të aseteve kulturore të gjithë territorit të tij”.

Për procedurën e ndjekur e cila duhet të jetë konform ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, ZAPKA duhet të bëjë me dije ASHA dhe Ministrinë e Kulturës.

3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR
ARTA DOLLANI

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

